



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.02.2025 | Nr: 115 | Ora: 12: 00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 21 ID, DATË 17.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË
KONSOLIDUARA/KRIIK**

Sot më datë 20.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

SUBJEKT: **Z. Ledion Lako**
Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Bregdetit

OBJEKT: Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të Institucione në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të sloganeve/hashtag-eve partiakë/elektoralë

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 17.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail.

Denoncimi është regjistruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 21 ID, në datën 17.02.2025.

Në këtë denoncim KRIIK parashtron sa vijon:



“Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, në faqet zyrtare në “Facebook” të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit janë duke u përdorur slogane elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve.

Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare në Facebook e Institucionit të mëposhtëm, Institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit:

- *Agjencia Kombëtare e Bregdetit.”*

Nga sa më sipër çmuj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Z. Ledion Lako, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

